

Kampi dy ditor me Grate e Dioqezes se Tiranes.



Kampi dy ditor me Grate e Dioqezes se Tiranes! Me mbështetjen e pakushtëzuar të Kryepiskopit Anastas në datat 22-23 qershor manastiri i hirshëm i shën Joan Vladimirit mirëpriti rreth 80 gra nga Dioqeza e Tiranës për kampin dy ditor që organizoi Lidhja e Grave Orthodhokse. Gratë pjesëmarrëse ishin nga Tirana përkatësisht nga Grupi i Grave të Katedrales, nga Shën Gjerasimi Kombinat, nga shën Prokopi dhe Grupi i Prindërve të Katedrales. Gjithashtu pjesë e minikampit ishin grupet e Grave nga Shkodra, Durrësi, Kavaja dhe Rrushkulli.
